

**Lorenc Antoni: FOLKLORI MUZIKUER SHQIPTAR I, Prishtinë, 1956, 8° f. 104.**

Muzikologu ynë i shquar dhe kompozitori më produktiv ndër ne, Lorenc Antoni, botoi përmbledhjen e parë të këngëve popullore shqiptare në botimin e shtëpisë botuese të Prishtinës „Milladin Popoviq”. Kjo vepër ka vleftë të posaçme, sepse është përmbledhja e parë e këngëve popullore shqipe ndër ne dhe njëkohësisht përfshin këngët më të mira dhe më të popullarizuara që këndohen nëpër ndeje, dasma, zifafete dhe solemnitete të tjera. Autori ka filluar të mbledhë lëndën melografike për këtë libër qysh me kohë, së pari në Shkup, ku ka jetuar një kohë të gjatë, mandej edhe nëpër terenet e Kosovës, Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Këngët janë kënduar prej grave, fëmijëve, djelmoshave dhe më të rriturve, kështu që ato edhe përkah përmbajtja paraqesin një larmi, e cila i bën edhe më të vlefshme. Bie në sy se prej 105 këngëve pjesën më të madhe e përbëjnë këngët nga Prizreni e nga rrethi i Gjakovës Pra, në këtë përmbledhje kemi këngë grash, fëmijësh, burrash nga katundet dhe qytetet. Megjithatë, si thotë vetë autori, këngët dhe lëndën kryesore e ka mbledhur në Prizren, ku është edhe vendi i këngës.

Meriton të theksohet se të gjitha këngët e kësaj përmbledhjeje janë mjaft melodioze dhe ritmike të caktuara në mënyrë mjaft koncize. Autori, për rendimin e këngëve, ka marrë për bazë vetinë metrike, që është edhe bazë e folklorit tonë muzikor. Ka filluar me takte të thjeshta dhe ka arritur

deri në ato më të ndërlikuarat. Disa këngë janë të prezentuara me gjashtë variante, që paraqesin një hegati meloritmike. Të gjitha këngët janë të transponuara, kështu që kanë tingullin e përbashkët, *tonus finalis*. Mbas çdo kënge, është bërë analiza me metodën finlandeze në katër rubrika. Tingujt e çdo kënge janë radhitur në rubrikën e parë dhe tregojnë lëndën e saj; në rubrikën e dytë intervali melodik tregon ambitusin e këngës; kadencat e çdo vargu melodik janë shënuar në rubrikën e tretë, kurse struktura formale e këngës është shënuar me germa të mëdha në rubrikën e katërt. Refrenet dhe interpolacionet janë të nënvizuara. Në fillim të çdo kënge është shënuar edhe metronomizimi i këngës, kurse në anën e djathtë është shënuar vendi se ku këndohet kënga. Pra, të gjitha elementet janë të shënuara, kështu që nuk është aspak vështirë të analizohet një këngë dhe të mësohen gjërat më elementare lidhur me atë se si duket ajo këngë me të gjitha karakteristikat e veta.

Lorenc Antoni këtë vepër ja kushton njohësit dhe dashamirit të folklorit muzikor shqiptar, kompozitorit të shquar jugosllav, Josip Sllavenskit. Kjo përmbledhje me analizat e veta do t'u shërbejnë shumë atyre që mirren me trajtimin e kësaj problematike dhe do të jetë një ndihmesë modeste për kulturën tonë të re, e sidomos atë muzikore që posa ka filluar të zhvillohet.

**Lorenc Antoni: FOLKLORI MUZIKUER SHQIPTAR II, Prishtinë, 1961, 8° f. të numëruara 115.**

Në këtë përmbledhje, të cilën autori ja kushton bashkëshortes së vet, Filomenës, kemi këngë të qytetit dhe të katundit; kështu kemi 57 këngë vetëm nga Opoja, katund afër Prizrenit, për të cilin autori thotë se është treva më e begatshme në

Kosovë, sa i përket melosit popullor. Përveç këtyre këngëve, në këtë përmbledhje mund të ndeshim edhe këngë nga Ferizaji, Rogova afër Gjakovës, Ulqini dhe shumë vise të tjera, ku banojnë shqiptarët. Këngët e kësaj përmbledhjeje janë mjaft interesante,

jo vetëm sa i përket konstruktit të tyre, por edhe melodikës së tyre të begatshme, ritmit dhe gjenezës. Kemi shumë këngë, që janë në masën 7/8 dhe 7/16. Në pjesën dërmuese të këtyre këngëve ndeshim strofat me refrene të përsëritura dhe me interpolacione të ndryshme; sidomos bie në sy llojlojshmëria e masave ritmike. Të gjitha këto këngë nuk janë të shënuara ashtu si këndohen, por janë të transponuara dhe të tëra kanë tingullin e fundin sol tonin finalis, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i vërejmë karakteristikat e përbashkëta dhe ndryshimet mes tyre. Mbas çdo këngë është dhënë analiza sipas metodës finlandeze në katër rubrika kryesore. Mirëpo, mbasi me këtë metodë nuk mund të përfshihen të gjitha finesat e melosit tonë të begatshëm, autori përdor dhe disa shenja të veçantë. Tingujt e çdo këngë janë radhitur në rubrikën e parë dhe pasqyrojnë materialin e shkallës muzikore, që është shënuar me notë të plotë tonika e tonali-

tetit të këngës. Intervalet melodike janë shënuar në rubrikën e dytë; ato tregojnë ambitusin e këngës, kurse kadenca e çdo këngë është e shënuar në rubrikën e tretë. Përveç këtyre, kemi shenjat e veçanta që tregojnë cezurën e parë dhe të dytë si dhe atë kryesore dhe shenjën për finalen e këngës. Për të gjitha ato këngë, që kanë katër vargje melodike, autori ka përdorur numrat, që tregojnë cezurën e parë dhe të dytë.

Në rubrikën e katërt është shënuar struktura formale e këngës, kurse në anën e djathtë është shënuar vendi ku këndohet kënga, ndërsa në anën e majtë metronomizimi. Pra, këto dhe shumë veti të tjera, që nuk kam mundur t'i shënoj në këtë vështrim, e bëjnë këtë përmbledhje mjaft interesante për çdokend. Njëkohësisht, kjo do t'u shërbejë edhe shumë gjeneratave mbas nesh që t'i njohin edhe më mirë këngët tona dhe njëkohësisht ato të mos harrohen dhe të këndohen edhe paskëta.

AKIL KOÇI

N